



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

BULETINI I SEKTORIT FINANCIAR

Zyra e Kryeekonomistit

Numër 8

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

BULETINI I SEKTORIT FINANCIAR

BOTUES Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Zyra e Kryeekonomistit
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 243
Faksi ++381 38 243 763

Faqja e internetit www.bqk-kos.org
Adresa elektronike research@bqk-kos.org

KRYEREDAKTOR Gani GËRGURI

KËSHILLI REDAKTUES Mentor GECI
Arben MUSTAFA
Mimoza MUSTAFA
Pal LEKAJ

REDAKTOR Valentin TOÇI

REDAKTOR TEKNIK Nazlije HOTI

Shtypur në "BLENDI" Prishtinë

Përdoruesit e të dhënave nga ky botim janë të lutur që të citojnë burimin.

Çdo korrigjim që mund të kërkohet do të bëhet në versionin elektronik në faqen e internetit.

Shtypet në 100 kopje.

SHKURTESAT:

AHN	Asetet e Huaja Neto
ATP	Agjensioni për Transferimin e Parave
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
ECB	Banka Qendrore Evropiane
FED	Federal Reserve
FMN	Fondi Monetare Ndërkombëtar
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KM	Komercijalna Banka
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
NF	Ndihmësit Financiar
NLB	Nova Ljubljanska Banka
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësi ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
SSD	Skema për Sigurimin e Depozitave
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Lista e Tabelave:

Tabela 1. Rrjeti i sektorit financiar.....	18
Tabela 2. Treguesit e performancës.....	29

Lista e Figurave:

Figura 1. Vlera mesatare e indeksit Dow Jones Industrial	12
Figura 2. Norma bazë të interesit e FED, ECB dhe Bank of England	13
Figura 3. Struktura e sistemit financiar	14
Figura 4. Pasqyra e sektorit financiar ndaj sektorëve tjerë	15
Figura 5. Struktura e aseteve të bankave komerciale sipas pronësisë	17
Figura 6. Indeksi Herfindahl–Hirschman për sektorin bankar	17
Figura 7. Asetet, kreditë dhe depozitat e sektorit bankar	18
Figura 8. Ekspozimi ndaj sektorit të brendshëm dhe të jashtëm.....	21
Figura 9. Struktura e aseteve.....	21
Figura 10. Struktura e kredive sipas sektorëve	22
Figura 11. Struktura e kredive të ndërmarrjeve afariste.....	23
Figura 12. Struktura e kredive sipas kohëzgjatjes	23
Figura 13. Struktura e detyrimeve	25
Figura 14. Struktura e depozitave	25
Figura 15. Struktura e depozitave sipas kohëzgjatjes	26
Figura 16. Struktura e të hyrave	26
Figura 17. Struktura e shpenzimeve	28
Figura 18. Normat e interesit	28
Figura 19. Treguesit e likuiditetit	30
Figura 20. Aktiviteti i kompanive të sigurimit	32
Figura 21. Aktiviteti kreditor i institucioneve mikro-financiare	33

Lista e Kutiaive:

Kutia 1. Recesioni në ekonominë e zhvilluar të tregut dhe efektet e mundshme në Kosovë.....	19
Kutia 2. Rreziku kreditor.....	24
Kutia 3. Rreziku i normës së interesit	27
Kutia 4. Rreziku i likuiditetit	30

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
2. AMBIENTI FINANCIAR NDËRKOMBËTAR	11
3. SEKTORI FINANCIAR NË KOSOVË	14
3.1. Karakteristikat e përgjithshme	14
3.2. Struktura e sektorit bankar.....	16
3.2.1. Aktiviteti i ndërmjetësimit financiar të sektorit bankar	18
3.2.2. Struktura e bilancit të gjendjes	20
3.2.3. Bilanci i suksesit	26
3.2.4. Normat e interesit	28
3.2.5. Treguesit e performancës së sektorit bankar	29
3.2.6. Likuiditeti dhe solvenca	29
3.3. Kompanitë e sigurimeve	31
3.4. Fondet e pensioneve.....	32
3.5. Institucionet mikro-financiare	33
3.6. Ndihmësit financiar	34
4. LISTA E KORPORATAVE FINANCIARE NË KOSOVË	35

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kriza financiare që ka kapluar sistemin financiar ndërkombëtar gjatë vitit 2008 ka paraqitur një sfidë për qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve të zhvilluara. Kjo krizë evoluoi në tregun e kredive hipotekare në SHBA, për tu shpërndarë pastaj edhe në sistemet bankare të vendeve tjera të cilat ishin të ekspozuara ndaj tregut financiar në SHBA. Efektet e krizës u transmetuan edhe në ekonominë reale ku shumica e vendeve zyrtarisht deklaruan hyrjen në recesion.

Përkundër vështirësive në tregun financiar ndërkombëtar, sistemi financiar i Kosovës vazhdoi të funksionojë normalisht, me përjashtim të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) i cili pati rënie në vlerën e aksioneve të investuara në bursat ndërkombëtare. Sektori bankar, që përfaqëson pjesën më të madhe të sektorit financiar të Kosovës, u karakterizua me një rritje të shkallës së ndërmjetësimit financiar. Në shtator 2008, kreditë e lëshuara nga sektori bankar arritën vlerën 1.1 miliard euro, e cila është për 37.0% më e lartë se sa në periudhën e njëjtë para një viti – rritja më e lartë që nga viti 2003. Struktura e kredive vazhdon të jetë e ngjashme dhe dominohet nga kreditë në sektorin e tregtisë. Sa i përket kohëzgjatjes, kreditë më afatgjata vazhdojnë të ngritin pjesëmarrjen e tyre në gjithsej portofolin. Një rritje signifikante është vërejtur edhe tek depozitat të cilat arritën vlerën 1.4 miliard euro, që është për 32.1% më e lartë se në shtator 2007.

Burim kryesor i depozitave vazhdojnë të jenë ekonomitë familjare, ndërsa në aspektin e maturitetit dominojnë depozitat me afat të shkurtër. Rritja e shkallës së ndërmjetësimit financiar deri në një masë është rezultat i rritjes së konkurrencës në sektorin bankar që, në mes tjerash, është manifestuar me norma të interesit më të favorshme për klientët si dhe cilësi më të lartë të shërbimeve. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të jetë profitabil, likuid dhe solvent. Gjendja e mirë e likuiditetit dhe solvencës së sektorit bankar tregohet edhe përmes rezultateve të nxjerra përmes modelit ‘stres-test’ i cili teston ndjeshmërinë e sektorit bankar në skenarë të ndryshëm.

Performancë pozitive është vërejtur edhe tek sektorët tjerë financiar. Industria e sigurimeve ka treguar se është sektor tërheqës për investitorët e ri pasi gjatë vitit 2008 edhe një kompani hyri në këtë treg. Për më tepër, përveç rritjes së aktivitetit me produktet ekzistuese, industria e sigurimeve në Kosovë filloi të ofrojë edhe një shërbim të ri – atë të sigurimit të jetës. Kompanitë e sigurimeve në Kosovë janë stabile me një nivel të kënaqshëm të kapitalizimit. Institucionet mikro-financiare vazhduan të përkrahin ekonominë vendore përmes kreditimit. Kreditë e lëshuara nga institucionet mikro-financiare arritën vlerën 89.1 milion euro që paraqet një rritje vjetore prej 26.3%.

2. AMBIENTI FINANCIAR NDËRKOMBËTAR

Sektori financiar ndërkombëtar po ballafaqohet me një rën nga krizat më të mëdha në histori. Kriza financiare, që tanimë ka marrë karakter global, filloi në SHBA dhe në masën më të madhe evoluoi gjatë viteve 2007-2008. Për shkak të shkallës së lartë të integritimit të sistemeve financiare ndërmjet vendeve, brenda një periudhe të shkurtër efektet e krizës u përhapen edhe në Evropë ku problemet fillimisht u shfaqën tek bankat e ekspozuara ndaj tregut në SHBA.

Shenjat e para të krizës financiare u shfaqën në SHBA në tregun e kredive hipotekare, të ashtuquajtura sub-prime,¹ treg ky që përjetoj një rritje të madhe si rezultat i kushteve të favorshme të kreditimit si për bankat ashtu edhe për klientët. Liberalizimi i tregut financiar në vitet e mëparshme, rritja e konkurrencës dhe normat e ulta të interesit bënë që bankat komerciale në SHBA të kenë një rritje të madhe të kredive duke aplikuar kritere më të ulëta të klasifikimit për kredimarrësit potencial. Rritja u vërejt më së shumti në tregun e kredive hipotekare, gjë që shkaktoi fryrje të madhe në kërkesën dhe çmimin e shtëpive. Presionet inflacioniste më pas shtynë FED-in të ngritë normat e interesit, dhe kjo pjesërisht ndikoi në rritjen e vështirësive në kthimin e kredisë nga kredimarrësit me gradim të ulët kreditor. Rrjedhimisht, dështimi i kthimit të këtyre kredive u pasua nga rënia drastike e çmimit të patundshmërive me efekt zingjiror për dështimin e mëtejshëm të kredive dhe përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor të bankave.

Për të zvogëluar rrezikun e ndërmarrë nga niveli i lartë i kreditimit, e veçanërisht nga kreditë me cilësi më të ulët, institucionet bankare shfrytëzuan një numër të instrumenteve të sofistikuara financiare të cilat vështirë u kontrolluan edhe nga rregullatori. Rezultati i kësaj ishte se këto instrumente financiare në realitet nuk e zbutën rrezikun por vetëm e fshehën dhe e shpërndanë, duke ndikuar edhe sektorët tjerë financiarë siç janë kompanitë e sigurimeve dhe bankat investive. Kriza kulmoi me bankrotimin e disa bankave me renome të cilat shkaktuan një shtrirje të shpejtë të krizës. Evoluimi i krizës shkaktoi pasiguri dhe mosbesim në tregun ndërbankar, që u manifestua me rritje të normës së interesit për kredi ndërbankare dhe rënie të ofertës së mjeteve likuide në këtë treg. Si pasojë, qasja në fonde përmes këtij tregu si në SHBA ashtu edhe në Evropë u vështirësua në masë të madhe dhe shumë banka u gjenden para problemeve serioze të likuiditetit.

Problemet e likuiditetit me të cilat po ballafaqohen bankat e prekura nga kriza kanë shkaktuar edhe zvogëlimin e kreditimit të sektorit real të ekonomisë duke ndikuar kështu që kriza financiare të transmetohet edhe në këtë sektor të ekonomisë. Shtërngimi i kredisë merr një kohë të shkurtër për t'u transmetuar në ekonominë reale me efekte negative për rritjen ekonomike dhe tanimë disa vende edhe zyrtarisht kanë deklaruar se ekonomitë e tyre kanë hyrë në recesion. Vështirësitë në financimin e bizneseve përmes sektorit bankar kanë krijuar një sentiment pesimist për aktivitetin ekonomik, gjë që ka shkaktuar rënie të besimit në

¹ Kreditë e lëshuara klientëve me gradim të ulët kreditor.

tregje. Si rezultat i kësaj, indekset e vlerës e aksioneve, si për shembull Dow Jones Industrial, shënuan rënie substanciale gjatë vitit 2008 (Figura 1). Rënia e aktivitetit ekonomik në vendet e prekura nga kriza po manifestohet me rënie të kërkesës së përgjithshme, e cila po shprehet përmes rënies së konsumit dhe nivelit të eksporteve, zvogëlim të prodhimit industrial dhe shkurtim të vendeve të punës. Kjo është reflektuar edhe në rënien e kërkesës për naftë, çmimi i së cilës ka zbritur në 44 dollarë për fuqi në dhjetor 2008 krahasuar me 147 dollarë sa ishte në korrik 2008.




Figura 1. Vlera mesatare e Dow Jones Industrial, 2006 – 2008

Si përgjigje ndaj situatës së krijuar, qeveritë dhe bankat qendrore pothuaj në të gjitha vendet e prekura nga kriza intervenuan për të zvogëluar pasojat e shkaktuara në ekonomitë e tyre. Masat më të shpeshta që janë ndërmarrë karakterizohen me politika monetare ekspansioniste përmes uljes së normave bazë të interesit nga ana e bankave qendrore (Figura 2), rritje të pragut të sigurimit të depozitave si dhe zotim të mjeteve për injektim në sektorin financiar. Sa i përket mjeteve të injektuara në sistemin financiar, fillimisht dominoi ideja për blerjen e kredive të këqija, mirëpo më pas u konsiderua se injektimi i mjeteve në formë të kapitalizimit të bankave është më efikas pasi që do të mundësojë bankat të vazhdojnë dhe zgjerojnë aktivitetin e tyre.




Figura 2. Norma bazë të interesit e FED, ECB dhe Bank of England

Qeveritë e vendeve të ndryshme po ashtu kanë planifikuar edhe ndërmarrjen e politikave ekspansioniste fiskale, me çka synohet stimulimi i kërkesës e cila është në rënie. Përveç masave individuale të ndërmarra nga shtete të ndryshme, karakteristikë e krizës aktuale është iniciativa për përgjigje të koordinuar ndërmjet shteteve të ndryshme. Kjo duket se ishte e domosdoshme duke pasur parasysh nivelin e lartë të integritetit të tregut financiar ndërkombëtar. Kështu, në Samitin mbi Tregjet Financiare dhe Ekonominë Botërore të mbajtur në nëntor 2008 në Uashington D.C., liderët e G20 u pajtuan për reformimin e politikave në pesë fusha si: fuqizimi i transparencës dhe përgjegjësisë, fuqizimi i rregulloreve të mbikëqyrjes financiare, promovimi i integritetit të tregjeve financiare, fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe reformimi i institucioneve financiare ndërkombëtare.

Sa i përket zhvillimeve në sektorët bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor, raportet e fundit të misioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) tregojnë se sektorët bankar në pjesën më të madhe të këtyre vendeve janë solvent, likuid dhe profitabil.² Megjithatë, qeveritë dhe bankat qendrore të këtyre vendeve tanimë kanë filluar hartimin e masave të ndryshme me qëllim të përballimit të ndonjë reflektimi nga kriza. Pritjet e vendeve të Ballkanit Perëndimor kryesisht shkojnë në drejtim të ndikimit të krizës në sektorin real të ekonomisë nga recesioni që tanimë është shfaqur në ekonomitë e zhvilluara. Reflektimi i këtij recesioni në ekonomitë e rajonit kryesisht do të mund të karakterizohej me rënie të eksporteve, rivlerësim të rrezikut nga ana investitorëve të huaj dhe rënie të investimeve të huaja direkte si dhe zvogëlim të remitancave, që për pjesën më të madhe të këtyre vendeve vazhdojnë të përfaqësojnë një burim shumë të rëndësishëm të financimit. Disa nga këto efekte tanimë kanë filluar të shfaqen në disa prej vendeve të rajonit dhe si rezultat është bërë edhe revidimi i projeksioneve për rritjen ekonomike gjatë vitit 2008 dhe 2009 që rezulton më e ulët

² <http://www.imf.org> [qasur më 1 dhjetor 2008].

se sa ishte paraparë fillimisht. Sidoqoftë, rritja ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të jetë pozitive.

3. SEKTORI FINANCIAR NË KOSOVË

3.1 Karakteristikat e përgjithshme

Sektori financiar i Kosovës vazhdon të zgjerohet duke rritur kështu kontributin në zhvillimin ekonomik si dhe gamën dhe cilësinë e produkteve të ofruara për klientët. Gjithsej asetet e sektorit financiar në shtator 2008 arritën vlerën 2.2 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 25.2%. Kjo rritje kryesisht rezulton nga rritja e sektorit bankar asetet e të cilit shënuan një rritje vjetore prej 30.9%.

Sektori financiar i Kosovës në masë të madhe dominohet nga bankat komerciale, asetet e të cilave në shtator 2008 përfaqësuan 79.2% të gjithsej aseteve. Pjesa tjetër e sektorit përbëhet nga fondet pensionale (12.7%), institucionet mikro-financiare (4.5%), kompanitë e sigurimeve (3.4%) dhe ndihmësit financiarë (0.2%). Siç mund të shihet edhe nga Figura 3, struktura e sistemit financiar mbetet kryesisht e njëjtë me vitin e kaluar, me përjashtim të një rritje të lehtë në pjesëmarrjen e sektorit bankar dhe rënie në pjesëmarrjen e Fondeve Pensionale dhe Kompanive të Sigurimit.




Figura 3. Struktura e sistemit financiar

Aktiviteti i sektorit bankar në Kosovë mbetet kryesisht bazik dhe mbështetet në kreditimin e ekonomisë vendore, ndërsa si burim kryesor të financimit ka depozitat të cilat mbledhen në Kosovë. Aktiviteti i sektorit të sigurimeve vazhdon të ketë për veprimtari kryesore policat e sigurimit të detyrueshëm për Përgjegjësi ndaj Palës së Tretë (PPT), ndërsa institucionet mikro-financiare merren me kreditimin e ekonomisë vendore (kryesisht bujqësinë dhe ekonomitë familjare) duke u financuar me linja kreditore nga jashtë. Kjo

strukturë e veprimtarisë së sektorit financiar ka mundësuar funksionimin normal të këtij sektori me gjithë krizën financiare globale me përjashtim të sistemit pensional, ku si pasojë e krizës financiare, është shënuar një rënie e vlerës së aksioneve të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) në bursat ndërkombëtare.

Karakteristikë e sektorit financiar të Kosovës është pjesëmarrja e lartë e kapitalit të huaj. Kjo veçanërisht vërehet tek sektori bankar dhe ai i sigurimeve ku 91.0% dhe 72.1% të gjithsej aseteve, respektivisht, menaxhohen nga kompanitë e huaja. Prezenca e institucioneve të huaja financiare në Kosovë ka dhënë kontribut të madh në zhvillimin e sistemit financiar përmes sjelljes së praktikave më të avancuara dhe nxitjes së konkurrencës.

Edhe gjatë vitit 2008, Asetet e Huaja Neto (AHN) të sektorit financiar të Kosovës (përfshirë BQK-në) vazhduan të rriten. Në shtator 2008, vlera e AHN arriti në 1.8 miliard euro që paraqet një rritje vjetore prej 10.8% (Figura 4). Shuma e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm regjistroi një rritje vjetore prej 13.1%, duke qëndruar në 1.9 miliard euro në shtator 2008. Kërkesat e sektorit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm kryesisht përfaqësohen nga depozitat, pjesëmarrja e të cilave në gjithsej asetet ishte 65.9% e që është për 6.6pp më e lartë se në vitin e kaluar. Kjo është rezultat i orientimit më të madh të investimeve drejtë depozitave të cilat konsiderohen si investime më të sigurta në kohën kur investimet në aksione dhe letra me vlerë po përjetojnë rënie të konsiderueshme të vlerës si rezultat i krizës financiare globale.




Figura 4. Pasqyra e sektorit financiar ndaj sektorëve tjerë

Në anën e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm është vërejtur një rritje vjetore prej 60.3%, e cila është dukshëm më e lartë se norma e rritjes së regjistruar gjatë periudhave të kaluara. Në shtator 2008, shuma e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm arriti në 128.2 milion euro e cila, me gjithë rritjen, përsëri mbetet në nivel të ulët krahasuar me kërkesat ndaj sektorit të jashtëm. Detyrimet e sektorit financiar të Kosovës ndaj sektorit

të jashtëm kryesisht përbëhen nga linjat kreditore që kanë institucionet financiare që operojnë në Kosovë (69.4% të gjithsej detyrimeve) dhe depozitat e jo-rezidentëve (30.6% të gjithsej detyrimeve).

Sa i përket raportit me sektorin e brendshëm, detyrimet e sektorit financiar të Kosovës ndaj qeverisë në shtator 2008 arritën vlerën 998.3 milion euro (850.2 milion euro në shtator 2007), të përbëra kryesisht nga depozitat e qeverisë në BQK, ndërsa sektori financiar vazhdon të mos ketë kërkesa ndaj qeverisë. Kërkesat e sektorit financiar ndaj sektorëve tjerë (kryesisht ndërmarrjet private dhe ekonomitë familjare), në shtator 2008 arritën vlerën 1.2 miliard euro dhe kryesisht përbëhen nga kreditë e lëshuara prej institucioneve financiare. Ndërsa, detyrimet ndaj sektorit real arritën vlerën 1.6 miliard euro (1.3 miliard euro në shtator 2007), të përbëra kryesisht nga depozitat e sektorit real në bankat komerciale.

3.2. Struktura e sektorit bankar

Sektori bankar i Republikës së Kosovës gjatë gjysmës së dytë të vitit 2007 dhe në fillim të vitit 2008 u karakterizua me hyrje të reja të bankave komerciale. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2007, Banka Kombëtare Tregtare (BKT) nga Shqipëria dhe Komercijalna Banka nga Serbia morën licencën për të operuar në tregun bankar në Kosovë. Në fund të vitit 2007, sistemit bankar të Kosovës iu bashkangjit edhe Türk Ekonomi Bankasi (TEB) nga Turqia e cila filloi operimin në Kosovë në janar të vitit 2008. Në janar të vitit 2008 po ashtu filloi aktivitetin edhe NLB Prishtina e cila u krijua nga bashkimi i dy bankave, Kasabank (KSB) dhe Banka e Re e Kosovës (BRK). Bashkimi i këtyre dy bankave ndodhi pasi NLB nga Sllovenia mori në pronësi pjesën më të madhe të aksioneve të KSB-së dhe BRK-së.

Sektori Bankar i Kosovës në shtator të vitit 2008 numëroi tetë banka komerciale, prej të cilave gjashtë në pronësi të huaj dhe dy në pronësi vendore. Dominimi i bankave me pronësi të huaj në sektorin bankar të Kosovës shprehet edhe përmes pjesëmarrjes së aseteve të bankave të huaja në gjithsej asetet e sektorit bankar, që në shtator të vitit 2008 përbënin 91.0% të gjithsej aseteve (Figura 5).

Struktura e tregut të sistemit bankar të Kosovës karakterizohet me një shkallë të lartë të koncentrimit ku asetet e tri bankave më të mëdha në shtator 2008 përfaqësuan 86.3% të gjithsej aseteve, që tregon një rritje prej 2.1pp krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje është kryesisht rezultat i bashkimit të KSB-së dhe BRK-së, që përfaqësuan bankën e tretë dhe të katërt më të madhe. Tri bankat më të mëdha kanë pjesëmarrje të ngjashme edhe në tregun e kredive dhe depozitave ku përfaqësojnë 88.0% dhe 88.5%, respektivisht. Shkalla e lartë e koncentrimit në sistemin bankar të Kosovës mund të shprehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH) mirëpo, si rezultat i hyrjes së bankave të reja, shkalla e koncentrimit shprehur përmes këtij treguesi ka shënuar një rënie të lehtë krahasuar me një vit më parë (Figura 6).




Figura 5. Struktura e asetëve të bankave komerciale sipas pronësisë

Në shtator të vitit 2008 IHH për asetet regjistroi 2,887 pikë krahasuar me 2,896 pikë në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa IHH për kreditë dhe depozitat regjistroi 3,014 dhe 3,016 pikë, respektivisht. Hyrja e bankave të reja në treg e që ka ndikuar në rënien e shkallës së koncentrimin, ka shfaqur efekte pozitive sa i përket konkurrencës në këtë sektor. Rritja e konkurrencës në sektorin bankar mund të vërehet nga rritja më e shpejtë në vëllimin e kredisë dhe të depozitave si dhe nga zvogëlimi i dallimit në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita. Gjithashtu, bankat komerciale kanë qenë më aktive në ofrimin e produkteve të reja për klientët.




Figura 6. Indeksi Herfindahl-Hirschman për sektorin bankar

Rritja e konkurrencës në sektorin bankar është shprehur edhe përmes zgjerimit më të shpejtë të degëve dhe nëndegëve (njësive) të bankave komerciale, në shtator 2008 numri i njësive bankare arriti në 276 nga 231 sa ishin një vit më parë (Tabela 1). Zgjerimi i numrit të njësive bankare kryesisht rezultoi nga hyrja e bankave të reja si dhe nga përpjekjet e bankave ekzistuese që, përmes hapjes së nëndegëve të reja, të shtrijnë

prezencën në një hapësirë sa më të gjerë. Gjithashtu, numri i bankomatëve shënoi një rritje të konsiderueshme duke arritur në 240 nga 155 në vitin e kaluar, gjë që ka bërë më të lehtë qasjen e klientëve në shërbimet bankare. Ngushtimi i mëtejme i distancës ndërmjet klientit dhe shërbimeve bankare duket të jetë prioritet shumë me rëndësi për sektorin bankar. Në këtë kontekst, numri i Pikave të Shitjes dhe llogarive 'E-banking' shënoi rritje të konsiderueshme duke arritur në 3,246 (2,554 në shtator 2007) dhe 13,051 (4,742 në shtator 2007), respektivisht.

Tabela 1. Rrjeti i sektorit bankar

	Shtator 2005	Shtator 2006	Shtator 2007	Shtator 2008
Numri i degëve dhe nëndegëve	232	219	231	267
Numri i bankomatëve	102	116	155	240
Numri i llogarive 'E-banking'	412	2,872	4,742	13,051
Numri i pikave të shitjes	1,138	1,767	2,554	3,246

3.2.1. Aktiviteti i ndërmjetësimit financiar të sektorit bankar

Asetet e sektorit bankar të Kosovës në shtator të vitit 2008 arritën vlerën 1.7 miliard euro që paraqet një rritje vjetore prej 30.9%. Shprehur si pjesë e PBB-së, asetet e sektorit bankar arritën në 45.7% nga 39.0% sa ishin në vitin e kaluar. Rritja e madhësisë së sektorit bankar kryesisht rezulton nga rritja e kredive bankare.




Figura 7. Asetet, kreditë dhe depozitat e sektorit bankar

Shkalla e ndërmjetësimit financiar të sektorit bankar të Kosovës, shprehur si raport i nivelit të kredive me PBB-në, arriti në 29.5% në shtator 2008 nga 24.1% në një vit më parë. Në shtator 2008 niveli i kredive arriti në 1.1 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 37.0%. Rritja e kredisë ishte si rezultat i rritjes së aktivitetit

ekonomik në Kosovë si dhe rritjes së konkurrencës në sektorin bankar që ka shtyrë bankat të zgjerojnë portofolin e tyre në mënyrë që të sigurojnë një pjesëmarrje sa më të lartë në treg. Rritja e nivelit të kredive ka rëndësi të veçantë për ekonominë e Kosovës në kohën kur ekonomitë e vendeve të prekura nga kriza financiare po ballafaqohen me shtrëngim të kredidhënies dhe si pasojë edhe ngadalësim të aktivitetit ekonomik (shih Kutinë 1).

Kutia 1. Recesioni në ekonomitë e zhvilluara të tregut dhe efektet e mundshme në Kosovë

Kriza financiare që ka kapluar sistemin financiar ndërkombëtar ka filluar të reflektohet edhe në sektorin real të ekonomive që janë prekur më shumë nga kriza. Për shkak të shkallës së lartë të integritit ekonomik, efektet e recesionit pritet të kenë implikime edhe në ekonomitë që nuk janë prekur direkt nga kriza financiare. Ekonomia e Kosovës, si një ekonomi e hapur, gjithashtu do të mund të bartë disa nga pasojat e recesionit në vendet e rajonit dhe më gjerë. Megjithatë, projeksionet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF) për vitin 2008 sugjerojnë një rritje reale ekonomike prej 6.6% dhe 5.2%, respektivisht, dhe deri më tani nuk kemi pasur ndonjë revidim të këtyre projeksioneve. Në anën tjetër, disa vende të rajonit kanë bërë një gjë të tillë dhe projeksionet e reviduara mbi rritjen ekonomike kanë rezultuar më të ulëta se projeksionet fillestare. Ndër efektet e para në sektorin real të ekonomive që janë prekur nga kriza ka qenë rënia e kërkesës që është reflektuar në rënien e konsumit të brendshëm dhe eksporteve. Sa i përket Kosovës, niveli i eksporteve nuk vërehet të jetë ndikuar deri më tani pasi që deri në shtator 2008 paraqitet më i lartë se sa në vitin e kaluar. Sidoqoftë, edhe në rast të rënies së nivelit të eksportit, pasojat për ekonominë e gjithmbarshme të Kosovës nuk do të jenë të larta për shkak të nivelit edhe ashtu të ulët të eksporteve.

Një kanal tjetër përmes të cilit ekonomia e Kosovës do të mund të ndikohej nga recesioni ekonomik në vendet tjera janë remitancat e emigrantëve Kosovar, të cilat paraqesin një burim shumë të rëndësishëm të financimit për ekonominë. Megjithatë, për vitin 2008 nuk duket se remitancat do të shënojnë rënie dhe vlerësimet preliminare tregojnë për një rritje krahasuar me vitin e kaluar. Kur kemi parasysh se recesioni ka filluar të thellohet në disa vende të BE-së, ku vërehet një shkurtim i konsiderueshëm i vendeve të punës, mund të pritët që gjatë vitit 2009 kjo do të reflektohet në nivelin e remitancave në Kosovë. Rënia e mundshme e remitancave do të ndikonte negativisht nivelin e konsumit dhe investimeve në Kosovë, çka do të mund të rezultonte në zvogëlim të aktivitetit ekonomik. Në këtë kontekst, vazhdimi i rritjes së kreditimit nga sektori bankar nën një menaxhim efikas të rrezikut është faktor shumë me rëndësi për mirëmbajtjen e nivelit të konsumit dhe investimeve. Niveli i kreditimit në Kosovë nuk ka ngecur për asnjë moment por, përkundrazi, ka shënuar nivel dukshëm më të lartë se në vitin e kaluar. Ngadalësimi eventual i kreditimit do të kishte efekte negative për rritjen ekonomike e cila më pas do të mund të reflektojë negativisht në vetë qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Një faktor tjetër me rëndësi për stimulimin e konsumit dhe investimeve në Kosovë është ekspansioni fiskal nga ana e qeverisë përbrenda kufijve të arsyeshmërisë. Për vitin 2009, qeveria ka rritur buxhetin e planifikuar në 1.4 miliard euro, ndërsa nga janari i vitit 2009 do të zbatohet ulja e normave të tatimit në të ardhura personale dhe fitim. Kjo pritet të stimulojë si konsumin – edhe pse këtu deri diku mund të ndikojë negativisht rritja e TVSH-së -, ashtu edhe investimet, duke përfshirë edhe investimet e huaja direkte (IHD) të cilat paraqesin një element shumë me rëndësi për zhvillimin

ekonomik të vendit. Niveli i IHD është drejtpërsëdrejti i lidhur me zhvillimet ekonomike në sektorin e jashtëm, që do të thotë se niveli i tyre në Kosovë mund të shënojë rënie si rezultat i recesionit në vendet e kapluara nga kriza. Megjithatë, niveli i IHD në Kosovë varet shumë nga elemente strukturore në ekonominë e Kosovës, siç është vazhdimi i procesit të privatizimit që deri më tani ka tërhequr në masë të konsiderueshme IHD. Progresi në procesin e privatizimit dhe privatizimi i mundshëm i Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK) dhe disa sektorëve të Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës (KEK), kompani këto me rëndësi të veçantë, premtojnë rritje substanciale të nivelit të IHD në Kosovë. Për më tepër, investimet në infrastrukturë dhe ulja e normave tatimore paraqesin elemente shumë të rëndësishme për tërheqjen e IHD.

Rritja e nivelit të kredive në masë të madhe është mbështetur nga rritja e nivelit të depozitave në sektorin bankar të cilat arritën vlerën 1.4 miliard euro në shtator 2008 (36.7% e PBB-së), që është për 32.1% më e lartë se sa në të njëjtën periudhë para një viti. Kjo normë e rritjes paraqet normën më të lartë të rritjes vjetore të depozitave që nga viti 2003. Kjo, deri në një masë, reflekton rritjen e konkurrencës në sektorin bankar të Kosovës, e cila është manifestuar edhe me një rritje të normave të interesit në depozita gjë që ka stimuluar depozitimin e aseteve në bankat komerciale. Për më tepër, rritja e konkurrencës ka shtyrë bankat të jenë më aktive në ofrimin e produkteve të reja, gjë që ka rritur atraktivitetin e depozitave.

3.2.2. Struktura e bilancit të gjendjes

Asetet e sektorit bankar të Kosovës vazhdojnë të dominohen nga kreditë e lëshuara në tregun vendor, çka nënkupton se sistemi bankar ka një ekspozim minimal ndaj sektorit të jashtëm (Figura 8). Kjo bënë që niveli i ndjeshmërisë së sektorit bankar të Kosovës ndaj zhvillimeve në tregjet financiare ndërkombëtare të jetë tejet i ulët dhe të mos paraqet ndonjë kërcënim serioz për qëndrueshmërinë e këtij sektori.




Figura 8. Ekspozimi ndaj sektorit të brendshëm dhe të jashtëm

Kreditë e lëshuara nga sistemi bankar përfaqësuan 64.6% të gjithsej aseteve në shtator 2008, që është një rritje prej 2.9pp krahasuar me një vit më parë (Figura 9). Në anën tjetër, zvogëlim të pjesëmarrjes në mjete ka shënuar bilanci me bankat komerciale që përfaqësoi 17.1% të gjithsej aseteve në shtator 2008 (17.5% në shtator 2007) dhe investimet në letra me vlerë të cilat përfaqësuan 2.4% (5.4% një vit më parë). Rënia e pjesëmarrjes së investimeve në letra me vlerë jashtë vendit dhe të bilanceve të bankave komerciale që operojnë në Kosovë me bankat komerciale jashtë vendit, dhe në anën tjetër rritja e vazhdueshme e kredive të lëshuara në ekonominë vendore, tregon se tregu vendor është më atraktiv për investimet e bankave.




Figura 9. Struktura e aseteve

Sa i përket ndryshimit në vëllimin e komponentëve të aseteve të sektorit bankar, një rritje e konsiderueshme është shënuar në nivelin e kredive që në shtator të vitit 2008 ishte për 37.0% më i lartë se një vit më parë. Rritja e nivelit të përgjithshëm të kredive kryesisht rezultoi nga rritja e kredive lëshuar korporatave jo-financiare (ndërmarrjeve). Kreditë dhënë ndërmarrjeve përfaqësojnë pjesën më të madhe të kredive të lëshuara nga sektori bankar. Në shtator 2008, këto kredi përfaqësuan 76.7% të gjithsej kredive, përderisa kreditimi i ekonomive familjare kishte pjesëmarrje 23.2% në gjithsej portfolion (Figura 10). Krahasuar me vendet tjera të rajonit, në Kosovë pjesëmarrja e kredive lëshuar ekonomive familjare në gjithsej kreditë mbetet në nivel më të ulët. Kjo kryesisht si pasojë e shkallës së lartë të papunësisë, shkallës së lartë të punëzënies jo-formale, nivelit të ulët të pagave si dhe afatit relativisht të shkurtër të kredive. Rritja e nivelit të kredive hipotekare është shumë me rëndësi për rritjen e kredive të ekonomive familjare, mirëpo niveli i këtyre kredive mbetet i ulët dhe atë kryesisht për shkak të problemeve në infrastrukturën ligjore.




Figura 10. Struktura e kredisë sipas sektorëve

Struktura e kredisë lëshuar ndërmarrjeve vazhdon të dominohet nga kreditë dhënë sektorit të shërbimeve të cilat përbëjnë 76.4% të gjithësej kredisë. Në kuadër të këtij sektori, tregtia ka pjesëmarrjen më të madhe (57.4% të gjithësej kredisë të ndërmarrjeve), gjë që reflekton varshmërinë e lartë të ekonomisë së Kosovës në këtë sektor (Figura 11). Kreditë e lëshuara sektorit të industrisë, energjisë dhe ndërtimtarisë përfaqësojnë 19.2% të gjithësej kredisë të pranuar nga ndërmarrjet, ndërsa ato në sektorin e bujqësisë u përfaqësojnë me 4.3%. Struktura e kredisë dhënë ndërmarrjeve tregon ekspozim të lartë të sektorit bankar kundrejt sektorit të tregtisë. Mirëpo, rritja e kreditimit të sektorëve të tjerë të ekonomisë, siç janë bujqësia, industria, etj., do të realizohet krahas zhvillimit të kapaciteteve për hartimin e projekteve nga kredimarrësit potencial. Rrjedhimisht, sektori bankar do të mund të kontribuonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e mëtejshëm të këtyre sektorëve.




Figura 11. Struktura e kredisë të ndërmarrjeve afariste

Rritja e vazhdueshme e kreditimit nga sektori bankar ka përkrahur në masë të madhe zhvillimin ekonomik të Kosovës, gjë që ka kontribuar në krijimin e një ambienti afarist më të aftë për të absorbuar kreditë. Kjo ka ngritur besimin e sektorit bankar ndaj mjedisit afarist në Kosovë, çka mund të shpjegohet edhe me rritjen e vazhdueshme të afateve të kredive të lëshuara. Për shembull, kreditë me kohëzgjatje prej më shumë se dy vite në shtator të këtij viti përfaqësuan 68.1% të gjithsej kredive krahasuar me rreth 45.0% në vitin 2005 (Figura 12).




Figura 12. Struktura e kredive sipas kohëzgjatjes

Cilësia e kredive në portofolin e sektorit bankar të Kosovës mbetet e mirë. Përkundër rritjes së shpejtë në vëllimin e kredisë, në shtator 2008 pjesëmarrja e kredive me probleme të cilat përfshijnë kreditë e klasifikuara si ‘të dyshimta’ dhe ‘të humbura’, në gjithsej portofolin u zvogëlua në 3.5% krahasuar me 4.3% në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjendja në portofolin kreditor paraqitet edhe më e mirë kur merret parasysh se kreditë me probleme janë të mbuluara me 170.9% nga rezervat për humbje nga kreditë, gjë që tregon se niveli aktual i kredive me probleme nuk paraqet rrezik për qëndrueshmërinë e sektorit bankar (shih Kutinë 2). Shikuar sipas sektorëve, kreditë dhënë ekonomive familjare paraqesin kreditë me më së paku probleme të kthimit.

Kutia 2. Rreziku kreditor është analizuar përmes modelit ‘stres-test’ në dy skenarët bazë: (i) supozimi mbi rritjen e vëllimit të kredive me problemeve ndaj gjithsej kredive dhe (ii) supozimi mbi migrimin e kredive nga një kategori në një kategori më të ulët.³ Të dy skenarët analizojnë ndikimin e tronditjeve të supozuara në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit si indikator i solvencës së sektorit. Rezultatet tregojnë se sektori

³ Supozimi kryesor në skenarin e migrimit të kredisë është që 75% e kredive nga kategoria 1 migrojnë në kategorinë 2 dhe 25% në kategorinë 3, ndërsa kategoritë 2, 3 dhe 4 migrojnë për një kategori më të ulët. Kategoritë sipas cilësisë së kredive janë: standarde (1), nën vëzhgim (2), nën-standarde (3), të dyshimta (4), të humbura (5).

bankar i Kosovës është në gjendje të ruaj treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit mbi nivelin minimal rregullativ prej 12% edhe në rast të rritjes së nivelit të kredive me probleme për 50%, 100% dhe 150%. Ky tregues bie nën 12% vetëm në rast të rritjes së kredive me probleme për 200%, por përsëri mbetet shumë afër minimumit rregullativ.

Në skenarin e dytë, supozimi kryesor është që 75% e kredive nga kategoria 1 migrojnë në kategorinë 2 dhe 25% në kategorinë 3, ndërsa kategoritë 2, 3 dhe 4 migrojnë për një kategori më të ulët. Kategoritë sipas cilësisë së kredive janë: standarde (1), nën vëzhgim (2), nën-standarde (3), të dyshimta (4), të humbura (5). Rezultatet sugjerojnë qëndrueshmëri të sistemit bankar edhe në këtë skenar, ku treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit zbret nga 16.8% (niveli fillestar) në 12.8% duke mbetur kështu përsëri mbi minimumin rregullativ.

Burimi kryesor i financimit të aseteve të sektorit bankar të Kosovës mbeten depozitat, të cilat në shtator 2008 përfaqësuan 80.3% të gjithë detyrimeve të sektorit bankar (Figura 14). Mbështetja e lartë e sektorit bankar në financimin përmes depozitave të mbledhura në Kosovë ka bërë që bankat komerciale të kenë ndjeshmëri minimale ndaj lëvizjeve në ofertën dhe koston e fondeve në tregjet financiare ndërkombëtare. Megjithatë, për të mbështetur një trend të tillë të nevojave të financimit që rrjedhin nga rritja e shpejtë e kredisë nevojitet një rritje më e shpejtë e depozitave. Kjo pjesërisht mund të arrihet përmes avancimit të mëtejshëm të sistemit të pagesave si dhe edukimit të bizneseve dhe qytetarëve për zhvillimin e aktivitetit të tyre përmes sistemit bankar. Pastaj, zvogëlimi i ekonomisë jo-formale dhe një kanalizim më adekuat i dërgesave të emigrantëve përmes sektorit bankar gjithashtu do të mund të kontribuonte në rritjen e depozitave. Krijimi i Skemës për Sigurimin e Depozitave (SSD), ligji mbi të cilën pritet të aprovohet në vitin 2009 nga Kuvendi i Kosovës, paraqet një hap shumë të rëndësishëm për rritjen e nivelit të depozitave në sektorin bankar pasi që shton sigurinë e depozitave. Qëllimet kryesore të SSD-së janë mbrojtja e depozitorëve të vegjël, harmonizimi me standardet Evropiane si dhe përkrahja e BQK-së në avancimin e qëndrueshmërisë dhe likuiditetit të sistemit financiar.⁴

⁴ Financimi i skemës për sigurimin e depozitave është paraparë të bëhet fillimisht me një donacion nga qeveria Gjermane përmes KfW, dhe më pastaj të gjitha bankat do të jenë të obliguara të kryejnë pagesën fikse fillestare në agjensionin përkatës për sigurimin e depozitave (0.3% e kapitalit), si dhe të vazhdojnë me pagesën e rregullt të primeve (prej 0.3% deri 1.5% e depozitave të siguruar, varësisht nga vlerësimi i agjensionit).




Figura 13. Struktura e detyrimeve

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës si burim kryesor kanë ekonomitë familjare, depozitat e të cilave përbëjnë 60.6% të gjithëj depozitave, ndërsa ato të ndërmarrjeve përfaqësojnë 32.1% (Figura 14). Në kuadër të depozitave të ndërmarrjeve, pjesa më e madhe vjen nga ndërmarrjet publike, depozitat e të cilave përfaqësojnë 17.7% të gjithëj depozitave në sektorin bankar, ndërsa ndërmarrjet private kanë 14.4%.




Figura 14. Struktura e depozitave

Struktura e depozitave sipas kohëzgjatjes mbetet e ngjashme me periudhat e kaluara. Në shtator 2008 depozitat e transferueshme përbënë 34.4% të gjithëj depozitave, përderisa 65.6% e gjithëj depozitave ishin depozita kursimi dhe të afatizuara. Struktura e depozitave kursimi dhe të afatizuara vazhdon të dominohet nga depozitat me kohëzgjatje prej më pak se një vit, të cilat përfaqësuan 82.5% të gjithëj depozitave në shtator 2008 (Figura 15).




Figura 15. Struktura e depozitave sipas kohëzgjatjes

3.2.3. Bilanci i Suksesit

Sektori bankar i Kosovës pothuajse gjatë gjithë periudhës së funksionimit të tij ka qenë i karakterizuar me bilanc pozitiv të fitimit. Në shtator 2008 fitimi neto i sektorit bankar arriti vlerën 29.4 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 19.0%. Kjo rritje kryesisht ka rezultuar nga rritja e vëllimit të kredisë gjatë kësaj periudhe dhe nga rritja e të hyrave nga interesi në kredi të cilat shënuan një rritje vjetore prej 39.0%.




Figura 16. Struktura e të hyrave

Në shtator 2008 të hyrat e realizuara nga sektori bankar arritën vlerën 142.3 milion euro, që paraqet një rritje prej 33.7% krahasuar me një vit më parë. Të hyrat e sektorit bankar të Kosovës varen në shkallë të lartë prej të hyrave nga interesi në kredi të cilat përbëjnë 71.6% të gjithë të hyrave (Figura 16). Kjo varësi e lartë në të hyrat nga interesi në kredi bën që fitimet e sektorit bankar të mund të jenë të ndjeshme nga lëvizjet e mundshme në normat e interesit në kredi. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme kur kemi parasysh se normat e

interesit në kredi mund të shënojnë rënie si rezultat i rritjes së vazhdueshme të konkurrencës në sektorin bankar. Megjithatë, rezultatet e modelit 'stres-test' për vlerësimin e rrezikut nga normat e interesit sugjerojnë se sektori bankar është në gjendje të përballojë edhe një lëvizje më të theksuar të normave të interesit (shih Kutinë 3).

Kutia 3. Rreziku i normës së interesit analizon ndjeshmërinë e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit si rezultat i ndryshimit të normave të interesit, që ndikon në koston e financimit dhe të hyrat e sektorit bankar. Në këtë analizë është konsideruar ulja/ngritja e normës së interesit në kredi/depozita dhe ndikimi i kësaj lëvizje në nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar. Një karakteristikë e veçantë e sektorit bankar në Kosovë është niveli shumë i ulët i aplikimit të normës variable të interesit. Pjesëmarrja e kredive me normë variable ndaj gjithsej portfolios së kredive është vetëm 2.4%, përderisa asnjë nga bankat në Kosovë nuk ofrojnë normë variable për depozita. Me qëllim të krijimit të një skenari më konzervativ, të gjitha kreditë dhe depozitat me maturitet deri në një vit janë konsideruar të kenë normë variable të interesit.

Sektori bankar është treguar mjaft i qëndrueshëm në raport me rrezikun e normave të interesit. Nën supozimin e rënies së normave të interesit në kredi për 1.5pp dhe ngritjes së normave në depozita për 1pp, rezultatet tregojnë se sektori bankar është i aftë për të mirëmbajtur nivelin e kapitalizmit dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar. Edhe nën supozimin më të ashpër hipotetik të konsideruar, atë të rënies së normave të interesit në kredi për 5pp dhe të ngritjes së normave në depozita për 1pp, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet mbi nivelin minimal të kërkuar. Në këtë rast, do të kishte rënie të konsiderueshme në të hyrat nga interesi (për rreth 45%), por që nuk do të kishte ndonjë pasojë serioze për nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Shpenzimet e sektorit bankar në shtator 2008 realizuan një rritje vjetore prej 35.2% duke shënuar vlerën 104.0 milion euro. Pjesa më e madhe e shpenzimeve të sektorit bankar përfaqësohet nga shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të cilat përbëjnë 57.6% të gjithsej shpenzimeve (Figura 17). Krahasuar me një vit më parë, kjo kategori e shpenzimeve rriti pjesëmarrjen me 1.5pp, kjo kryesisht si rezultat i zgjerimit të vazhdueshëm të rrjetit të bankave. Shpenzimet e interesit në depozita rritën pjesëmarrjen në gjithsej shpenzimet nga 24.1% në shtator 2007 në 25.6% në shtator 2008, duke reflektuar deri në një masë ngritjen e normës së interesit në depozita.




Figura 17. Struktura e shpenzimeve

3.2.4. Normat e Interesit⁵

Rritja e numrit të bankave që operojnë në Kosovë ka rezultuar në rritjen e konkurrencës për mbledhjen e depozitave. Si rezultat, norma efektive mesatare e interesit në depozita, për periudhën janar-shtator 2008, arriti në 4.13% krahasuar me 3.11% në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 18). Efektet e konkurrencës vërehen edhe në normat e interesit në kredi⁶, mesatarja e të cilave për periudhën janar-shtator 2008 ishte 13.80% krahasuar me 14.68% në periudhën e njëjtë para një viti. Si rezultat, edhe mesatarja e dallimit në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita zbriti në 9.67pp krahasuar me 11.56pp në vitin e kaluar.




Figura 18. Normat e interesit

⁵ Normat e interesit janë mesatare të ponderuara sipas produkteve dhe afateve të ndryshme.

⁶ Normat e interesit në kredi që nga periudha janar 2008 përmbajnë edhe shpenzimet administrative. Për qëllime të përputhjes metodologjike me periudhat e mëhershme, normat e interesit në kredi në këtë publikim nuk përfshijnë shpenzimet administrative.

Normat e interesit në kredi vazhdojnë të konsiderohen të larta, por që pritet të shënojnë rënie të mëtutjeshme me rritjen e konkurrencës dhe përmirësimit të efikasitetit në sektorin bankar. Në rënien e normave të interesit në kredi mund të kontribuojnë edhe vetë bizneset, ku në mes tjerash, shumë me rëndësi është avancimi i kapaciteteve planifikuese të cilat do të ngritin arsyeshmërinë e projekteve me të cilat aplikohet për kredi. Gjithashtu, përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar nga ana e bizneseve si dhe një sistem gjyqësor më efikas do të kishte një rol shumë me rëndësi në zvogëlimin e normave të interesit.

3.2.5. Treguesit e performancës së sektorit bankar

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me profitabilitet të qëndrueshëm. Kthimi Mesatar në Asete (KMA) në shtator 2008 mbeti në rreth 2.5% (Tabela 2). Megjithatë, Kthimi Mesatar në Kapital (KMK) shënoi një rënie vjetore prej 4.0pp, duke qëndruar në 22.2% në shtator 2008. Rënia e KMK kryesisht i atribuohet rritjes më të shpejtë të kapitalit aksionar në sektorin bankar.

Tabela 2. Treguesit e performancës

	Dhjetor2005	Dhjetor 2006	Dhjetor 2007	Shtator 2008*
KMA	1,5	1,9	2,6	2,5
KMK	20,1	22,4	26,2	22,2
MNI	6,7	6,4	7,1	7,3
Treguesi i jo-efikasitetit	5,5	5,1	5,4	5,1

*Të dhënat e analizuara.

Margjina Neto e Interesit (MNI), që paraqet ndryshimin në mes të hyrave nga interesi dhe shpenzimeve të interesit në raport me mesataren e aseteve, në shtator 2008 ishte 7.3% krahasuar me 7.1% në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Indikator i jo-efikasitetit, që paraqet pjesëmarrjen e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative në mesataren e aseteve, u zvogëlua në 5.1% në shtator 2008 nga 5.4% në shtator 2007, çka sugjeron një rritje të lehtë të efikasitetit në sektorin bankar. Në anën tjetër, numri mesatar i punonjësve për një njësi bankare tregon një rënie të lehtë të efikasitetit duke arritur në 13.4 nga 12.3 sa ishte në dhjetor 2007.

3.2.6. Likuiditeti dhe solvenca

Shkalla e likuiditetit në sistemin bankar të Kosovës mbetet në nivel të kënaqshëm përkundër rritjes së shpejtë të kredisë. Në qershor të këtij viti rritja më e shpejtë e kredisë krahasuar me rritjen e depozitave u reflektua në një raport kredi-depozita prej 86.2%. Megjithatë, një ngadalësim i lehtë në normën e rritjes së kredisë si dhe

një normë më e lartë e rritjes së depozitave bëri që në shtator raporti kredi-depozita të bie në 80.5%, nivel ky që ndodhet brenda marginës së rekomanduar nga BQK-ja (Figura 19).




Figura 19. Treguesit e likuiditetit

Rritja e shpejtë e kredisë është reflektuar edhe në pjesëmarrjen e aseteve likuide në gjithsej asetet. Në shtator 2008 pjesëmarrja e aseteve likuide në gjithsej asetet shënoi nivelin 30.7% që është për 4.3pp më i ulët se në shtator 2007. Vlerësimi i rrezikut të likuiditetit përmes modelit 'stres-test' tregon se sektori bankar i Kosovës është likuid, që do të thotë se mund të përmbushë detyrimet (shih Kutinë 4).

Kutia 4. Vlerësimi i rrezikut të likuiditetit analizon aftësinë e bankave që të përballojnë tërheqje të konsiderueshme të depozitave. Rezultatet e analizës kanë treguar një nivel të kënaqshëm të likuiditetit në sektorin bankar. Analiza ka qenë mjaft konzervative, duke konsideruar si asete 100% likuide vetëm paratë e gatshme dhe pjesën e rezervës së bankave që tejkalon nivelin minimal të kërkuar nga BQK (bazuar në rregulloren mbi rezervën minimale). Në anën tjetër, janë bërë supozime të ndryshme mbi nivelin e likuiditetit të aseteve tjera si depozitat në bankat jashtë vendit dhe letrat me vlerë. Gjithashtu, për ti dhënë skenarit karakter më konzervativ, fare nuk është konsideruar mundësia e shfrytëzimit të ndonjë linje kreditore si burim i likuiditetit.

Nën supozimin se plasmanet dhe letrat me vlerë jashtë vendit janë 100% likuide, sektori bankar mund të përballojë një tërheqje prej 24% të gjithsej depozitave pa pasur nevojë për likuiditet shtesë. Edhe nën supozimin më të ashpër se bankat nuk do të kenë fare qasje në plasmanet dhe letrat me vlerë jashtë vendit, sektori bankar është treguar likuid. Në këtë rast, sektori bankar do të mund të përballonte tërheqje deri në 6%

të depozitave pa pasur nevojë për likuiditet shtesë. Andaj, mund të konsiderohet se sektori bankar i Kosovës është në gjendje të përballojë ndonjë tërheqje eventuale më të theksuar të depozitave.

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të jetë solvent, me një shkallë të kënaqshme të kapitalizmit. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, që paraqet raportin ndërmjet kapitalit dhe asetëve që bartin rrezik të kthimit, në shtator 2008 qëndroi në 16.8% që paraqet një nivel dukshëm më të lartë se 12% - niveli minimal i përcaktuar nga rregullatori. Për më tepër, ky tregues tejkalon nivelin minimal tek të gjitha bankat komerciale të cilat operojnë në Kosovë. Krahasuar me vitin paraprak, mjaftueshmëria e kapitalit paraqitet për 1pp më e ulët, që është rezultat i rritjes më të shpejtë të kredisë e cila është reflektuar në një rritje më të shpejtë të asetëve të rrezikuara në krahasim me kapitalin. Siç u tregua edhe nga analiza e rrezikut kreditor dhe të normës së interesit (Kutia 2 dhe 3), treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet në nivel më të lartë se minimumi i kërkuar edhe në skenarët e ndryshëm të shqyrtuar.

3.3. Kompanitë e sigurimeve

Industria e sigurimeve paraqet një tjetër sektor shumë të rëndësishëm të sistemit financiar të Kosovës. Në maj 2008 numri i kompanive të sigurimeve të cilat operojnë në Kosovë arriti në dhjetë me hyrjen e kompanisë “ELSIG” e cila fillimisht kishte pronësi vendore, ndërsa në tetor 2008 kaloi në pronësi të huaj. Kjo tregon se industria e sigurimeve në Kosovë mbetet një sektor tërheqës për investitorët e huaj që shpjegohet edhe nga fakti se nga dhjetë kompani të cilat operojnë në Kosovë, shtatë janë në pronësi të huaj dhe menaxhojnë 72.1% të gjithsej asetëve të sektorit të sigurimeve. Që nga prilli i këtij viti, BQK lejoi liberalizimin e kontrolluar në përcaktimin e tarifave për policat PPT. Me këtë veprim është nxitur konkurrenca në tregun e sigurimeve dhe pritët që kjo të reflektohet në ngritje të mëtutjeshme të efijencës dhe cilësisë së shërbimeve në këtë sektor. Gjatë vitit 2008, industrisë së sigurimeve në Kosovë iu shtua edhe një segment i ri – sigurimi i jetës. Shërbimet e sigurimit të jetës paraqesin një veprimtari të re për tregun e sigurimeve në Kosovë dhe ofrohen vetëm nga një kompani e sigurimeve.

Në shtator 2008 gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën 74.8 milion euro, që paraqet një rritje prej 9.9% krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Pjesa më e madhe e asetëve të kompanive të sigurimeve përfaqësohen nga depozitat të cilat përbëjnë 70.1% të gjithsej asetëve. Në anën tjetër, elementi kryesor i detyrimeve vazhdon të jetë kapitali aksionar, i cili përfaqëson 47.1% të gjithsej të detyrimeve të kompanive të sigurimeve që operojnë në Kosovë. Zgjerimi i aktivitetit të industrisë së sigurimeve shprehet edhe përmes primeve të pranuar nga kompanitë e sigurimeve, vlera e të cilave në shtator 2008 arriti në 43.8 milion euro që është për 9.4% më e lartë se në shtator 2007 (Figura 20). Aktiviteti i industrisë së sigurimeve në

Kosovë vazhdon të koncentrohet kryesisht në sigurimin e automjeteve motorike përmes policave PPT, të cilat në shtator 2008 gjeneruan 64.5% të gjithsej primeve të pranuar. Pjesa tjetër e primeve të pranuar rrjedhë nga policat kufitare dhe ato jo-PPT të cilat në shtator 2008 përfaqësuan 19.9% dhe 15.6% të gjithsej primeve, respektivisht. Në anën tjetër, dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve në shtator 2008 arritën vlerën 12.9 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 32.4% e cila është më e lartë se sa rritja vjetore e primeve të pranuar. Si pasojë, në shtator 2008 raporti dëme ndaj primeve arriti në 29.5% (24.3% në shtator 2007), që do të thotë se afër një e treta e primeve të pranuar paguhet për kompensimin e dëmeve të të siguruarve.




Figura 20. Aktiviteti i kompanive të sigurimit

Në shtator 2008 raporti i kapitalit ndaj gjithsej aseteve, që tregon shkallën e kapitalizimit të industrisë, shënoi një rënie vjetore prej 1.8pp duke qëndruar në 47.1%. Shkalla e kapitalizimit tregon aftësinë e sektorit për të përballuar humbjet eventuale të cilat mund të paraqiten si pasojë e tronditjeve të ndryshme të cilat mund të shfaqen. Një tregues tjetër i rëndësishëm për të vlerësuar shëndetin e industrisë së sigurimeve është raporti i kapitalit ndaj rezervave teknike i cili në shtator 2008 qëndroi në 114.1% (112.0% në shtator 2007).

3.4. Fondet e pensioneve

Fondet pensionale paraqesin sektorin e vetëm të sistemit financiar të Kosovës që është prekur nga kriza financiare ndërkombëtare. Më konkretisht, kjo krizë ka goditur në mënyrë të drejtpërdrejtë Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Që nga fillimi i vitit e deri në shtator 2008, vlera e kursimeve të qytetarëve në TKPK ka shënuar një rënie prej 16.7% (49 milionë euro), ndërsa ka vazhduar të bie edhe në tremujorin e katërt 2008. Rënia në vlerën e kursimeve është si pasojë e rënies së vlerës së aksioneve në investimet e TKPK-së jashtë vendit të cilat kanë ndjekur trendin global të rënies së vlerës së aksioneve në të gjitha bursat. Megjithatë, vlera e aksioneve pritet të rikuperohet si rezultat i masave të marra nga qeveritë e

ekonomive më të fuqishme botërore, të cilat kanë për qëllim kthimin e stabilitetit dhe besimit në tregjet financiare.

Rënia e vlerës së kursimeve në TKPK, që paraqet fondin më të madh të pensioneve në Kosovë, ka ndikuar në masë të konsiderueshme vëllimin e tërësishëm të aseteve të sistemit pensional të Kosovës. Në shtator 2008 gjithsej asetet e fondeve pensionale që operojnë në Kosovë, arritën vlerën 280.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej vetëm 2.0% krahasuar me 38.0% në shtator 2007. Pjesa më e madhe e aseteve të sistemit të pensioneve janë të investuara në aksione dhe forma të tjera të kapitalit të cilat përbëjnë 56.7% të gjithsej aseteve (61.8% në shtator 2007). Investimet në letra me vlerë jo-aksione përfaqësojnë 31.8% të gjithsej aseteve, ndërsa 11.5% e aseteve janë të investuara në formë të depozitave. Krahasuar me periudhën e njëjtë para një viti, pjesëmarrja e investimeve në depozita në gjithsej asetet është rritur me 7.0pp dhe kjo kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të fondeve të pensioneve në bankat komerciale që operojnë në Kosovë dhe në BQK.

3.5. Institucionet mikro-financiare

Aktiviteti i Institucioneve Mikro-Financiare (IMF) në Kosovë kryesisht bazohet në kreditimin e ekonomisë vendore. Në shtator 2008 gjithsej asetet e këtyre institucioneve arritën vlerën 99.0 milionë euro e cila është për 19.4% më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë (Figura 21). Asetet e IMF-ve kryesisht përbëhen nga kreditë, pjesëmarrja e të cilave në gjithsej asetet u rrit në 90.0% (85.1% në shtator 2007).




Figura 21. Aktiviteti kreditor i institucioneve mikro-financiare

Në aspektin e vëllimit, kreditë e lëshuara nga IMF shënuan një rritje vjetore prej 26.3%, duke arritur vlerën 89.1 milionë euro. Megjithatë, pjesëmarrja e kredive të lëshuara nga IMF në gjithsej kreditë e lëshuara

nga sistemi financiar shënoi një rënie vjetore prej 0.6pp, duke qëndruar në 7.3%. Kjo si rezultat i rritjes më të shpejtë në kreditë e lëshuara nga bankat komerciale.

Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të IMF janë linjat kreditore nga jashtë të cilat përfaqësojnë 54.9% të gjithsej detyrimeve të këtyre institucioneve. Linjat kreditore të mara nga jashtë në shtator 2008 arritën vlerën 54.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 76.5%.

3.6. Ndihmësit Financiarë

Ndihmësit Financiar (NF) që veprojnë në Kosovë kryesisht përfaqësohen nga Byrotë e Këmbimit dhe Agjensionet për Transferimin e Parave (ATP). Në shtator 2008 transferimi i parave me sektorin e jashtëm përmes institucioneve financiare ka shënuar një rritje të konsiderueshme vjetore (31.5% krahasuar me 19.3% në shtator 2007) duke arritur vlerën 3.6 miliard euro. Rritje më të madhe kanë regjistruar transferet nga Kosova të cilat arritën vlerën 2.1 miliard euro (1.5 miliard në shtator 2007), ndërsa transferet e pranuar nga jashtë arritën në 1.5 miliard euro (1.3 miliard në shtator 2007). Megjithatë, pjesëmarrja e shumës së parave që transferohen përmes NF në gjithsej shumën e parave të transferuara përmes institucioneve financiare ka shënuar rënie. Deri në shtator 2008, përmes NF janë pranuar 10.3% të gjithsej transfereve të pranuar në Kosovë krahasuar me 11.2% në periudhën e njëjtë para një viti, ndërsa vetëm 0.7% të dërgesave nga Kosova janë transferuar përmes NF (0.9% në shtator 2007). Në Kosovë, pjesa më e madhe transfereve me sektorin e jashtëm realizohet përmes bankave komerciale.

4. LISTA E KORPORATAVE FINANCIARE NË KOSOVË

Sektori bankar

(Deri në shtator 2008)

PROCREDIT BANK

Adresa: Rr. Nëna Terezë Nr. 16, Prishtinë

Tel: ++381 38/ 555 777

Faksi: ++38138/ 248 777

Adresa elektronike: info@procreditbank-kos.comFaqa e internetit: www.procreditbank-kos.com**Bilanci i Gjendjes**

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në mijëra euro)

Asetet	Shuma	Detyrimet	Shuma
Paraja e gatshme dhe bilancet me BQK	78,585	Bilanci me bankat tjera	4,574
Bilanci me bankat komerciale	84,723	Depozitat	575,728
Letrat me vlerë	40,417	Huamarrje të tjera	...
Kreditë	434,118	Detyrime të tjera	32,012
Asetet fikse	15,121	Borxhi i ndërvuarur	7,010
Asetet tjera	12,340	Burimet vetjake	45,980
GJITHSEJ ASETET	665,304	GJITHSEJ DETYRIMET	665,304

RAIFFEISEN BANK

Adresa: Rr. UÇK Nr. 51, Prishtinë
 Tel: ++381 38/ 226 400, 401
 Faksi: ++38138/ 226 408
 Adresa elektronike: info@raiffeisen-kosovo.com
 Faqja e internetit: www.raiffeisen-kosovo.com

Bilanci i Gjendjes

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në mijëra euro)

Asetet		Detyrimet	
	Shuma		Shuma
Paraja e gatshme dhe bilancet me BQK	58,581	Bilanci me bankat tjera	17,094
Bilanci me bankat komerciale	129,477	Depozitat	493,966
Letrat me vlerë	...	Huamarrje të tjera	...
Kreditë	412,056	Detyrime të tjera	31,143
Asetet fikse	6,610	Borxhi i ndërvuarur	...
Asetet tjera	5,284	Burimet vetjake	69,805
GJITHSEJ ASETET	612,008	GJITHSEJ DETYRIMET	612,008

NLB PRISHTINA

Adresa: Rr. Rexhep Luci Nr. 5, Prishtinë
 Tel: ++381 38/234 111
 Faksi: ++381 38/246 189
 Adresa elektronike: info@nlbprishtina.com
 Faqja e internetit: www.nlbprishtina.com

Bilanci i Gjendjes

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në mijëra euro)

Asetet	Shuma	Detyrimet	Shuma
Paraja e gatshme dhe bilancet me BQK	20,776	Bilanci me bankat tjera	10,495
Bilanci me bankat komerciale	53,336	Depozitat	172,574
Letrat me vlerë	1,100	Huamarrje të tjera	...
Kreditë	147,943	Detyrime të tjera	22,001
Asetet fikse	4,770	Borxhi i ndërvuarur	...
Asetet tjera	4,153	Burimet vetjake	27,008
GJITHSEJ ASETET	232,078	GJITHSEJ DETYRIMET	232,078

BANKA EKONOMIKE

Adresa: Rr. Migjeni Nr. 1, Prishtinë
 Tel: ++381 38/244 396
 Faksi: ++381 38/243 828
 Adresa elektronike: bek@ekonomike.com
 Faqja e internetit: www.bekonomike.com

Bilanci i Gjendjes

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në mijëra euro)

Asetet	Shuma	Detyrimet	Shuma
Paraja e gatshme dhe bilancet me BQK	7,694	Bilanci me bankat tjera	...
Bilanci me bankat komerciale	15,041	Depozitat	60,050
Letrat me vlerë	...	Huamarrje të tjera	...
Kreditë	47,623	Detyrime të tjera	2,036
Asetet fikse	1,708	Borxhi i ndërvuarur	...
Asetet tjera	1,760	Burimet vetjake	11,740
GJITHSEJ ASETET	73,826	GJITHSEJ DETYRIMET	73,826

BANKA PËR BIZNES

Adresa: Rr. UÇK Nr. 41, Prishtinë
 Tel: ++381 38/ 244 666
 Faksi: ++38138/ 243 656, 243 657
 Adresa elektronike: info@bpbbank.com
 Faqja e internetit: www.bpbbank.com

Bilanci i Gjendjes

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në mijëra euro)

Asetet	Shuma	Detyrimet	Shuma
Paraja e gatshme dhe bilancet me BQK	7,465	Bilanci me bankat tjera	...
Bilanci me bankat komerciale	14,742	Depozitat	42,777
Letrat me vlerë	...	Huamarrje të tjera	...
Kreditë	29,487	Detyrime të tjera	3,317
Asetet fikse	1,433	Borxhi i ndërvuarur	...
Asetet tjera	767	Burimet vetjake	7,800
GJITHSEJ ASETET	53,894	GJITHSEJ DETYRIMET	53,894

KOMERCIJALNA BANKA

Adresa: Rr. Kralja Petra Prvog Nr. 33, Mitrovica
 Tel: ++381 38/423 822
 Faksi: ++ 381 28/425 295
 Adresa elektronike: posta@kombank.com
 Faqja e internetit: www.kombank.com

Bilanci i Gjendjes

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në mijëra euro)

Asetet	Shuma	Detyrimet	Shuma
Paraja e gatshme dhe bilancet me BQK	9,565	Bilanci me bankat tjera	...
Bilanci me bankat komerciale	...	Depozitat	29,461
Letrat me vlerë	...	Huamarrje të tjera	...
Kreditë	4,708	Detyrime të tjera	194
Asetet fikse	...	Borxhi i ndërvuarur	...
Asetet tjera	21,232	Burimet vetjake	5,850
GJITHSEJ ASETET	35,505	GJITHSEJ DETYRIMET	35,505

TÛRK EKONOMI BANKASI

Adresa: Rr. Agim Ramadani Nr. 15, Prishtinë

Tel: ++381 38/230 000

Faksi: ++ 381 38/224 699

Adresa elektronike: info@teb-kos.com

Faqja e internetit: www.teb-kos.com

Bilanci i Gjendjes

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në mijëra euro)

Asetet	Shuma	Detyrimet	Shuma
Paraja e gatshme dhe bilancet me BQK	4,272	Bilanci me bankat tjera	...
Bilanci me bankat komerciale	2,532	Depozitat	23,236
Letrat me vlerë	...	Huamarrje të tjera	...
Kreditë	25,244	Detyrime të tjera	887
Asetet fikse	3,043	Borxhi i ndërvuarur	...
Asetet tjera	222	Burimet vetjake	11,191
GJITHSEJ ASETET	35,313	GJITHSEJ DETYRIMET	35,313

BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Adresa: Rr. Garibladi Nr. 33, Prishtinë
 Tel: ++381 38/246 180
 Faksi: ++ 381 38/543 699
 Adresa elektornike: infoBktKosova@bkt.com.al
 Faqja e internetit: www. bkt.com.al

Bilanci i Gjendjes

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në mijëra euro)

Asetet	Shuma	Detyrimet	Shuma
Paraja e gatshme dhe bilancet me BQK	7,667	Bilanci me bankat tjera	...
Bilanci me bankat komerciale	...	Depozitat	6,008
Letrat me vlerë	...	Huamarrje të tjera	...
Kreditë	3,345	Detyrime të tjera	163
Asetet fikse	787	Borxhi i ndërruarur	...
Asetet tjera	734	Burimet vetjake	6,362
GJITHSEJ ASETET	12,533	GJITHSEJ DETYRIMET	12,533

Korporatat tjera financiare

Ndermjetësuesit tjerë financiar	FINCA, KEP, Gramen Trust, Agency for Finance in Kosovo, Cordaid, Besëlidhja Micro Finance, Kreditimi Rural i Kosovës, Kosinvest World Vision, Mështekna, Centro Laici Italiani per le Mission, START, Perspektiva 4, AgroBusiness Development Unit, Kosova Aid and development, Atlantic Capital Partners, Vllasa - Co, Crimson Finance Fund.
Fondet pensionale	TKPK, Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve.
Kompanitë e sigurimeve	Croatia Insurance, Dardania, Dukagjini, Insingu, Kosova e Re, Sigal-Drini, Sigkos, Sigma, Siguria, Elsig.
Ndihmësit financiar	<p>Menaxher i Aseteve: Fondi Sloveno Kosovar.</p> <p>Agjencionet për transferin e mjeteve: DMTH, PCB Western Union, RZBK Western Union, Union Financiar Prishtina, E&S Efikasiteti Siguria Llc., Posta dhe Telekomunikimi i Kosovës (PTK).</p> <p>Këmbimoret: Agimi, Agoni, Beni, Euro, Euro Eki, Euro Kembimi, Euro-Cufa, Gipa, Indriti, Monedha, NBS, Prizreni, Valuta, Xeni, Ximi, E-Bani, Te Gazi, Pëllumbi, Hamza, Veli, Mena.</p>

